



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 01-01/24

Datë: 31. 01. 2024, ora 15<sup>00</sup>

### PROCESVERBAL

Mbledhja e Parë e Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më datën 31 Janar, 2024, në orën 15<sup>00</sup>, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Këshilli si në vijim:

1. Ruzhdi Shehu-kryetar i Komunës-Kryesues i KKSB-së,
2. Rasim Sylja-komandant i Stacionit Policor në Junik,
3. Xhavit Velijaj-drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
4. Zejnepe Gaxherri-kryesuese e Komitetit për Komunitete,
5. Xhavit Gaxherri-kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut,
7. Shkëlzen Shehu-përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale,
8. Qamil Jasiqi-përfaqësues nga Komuniteti i Personave me Aftësi të Kufizuara,
9. Afërdita Shehu-kryesuese e Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, dhe
10. Arbër Gjota-përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike.

Në këtë mbledhje munguan; Albestrim Rexhepi-përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Leonita Jasiqi-përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Arsim Shehu-përfaqësues nga Komuniteti i Biznesit, Dukagjin Llloni-përfaqësues nga OJQ, Imer Krasniqi-përfaqësues i Bashkësisë Islame, dhe Driton Sylja-“Teqja e Madhe Amë e Tarikatit Alijjei- Haletije Xhaferi”, Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i Komunës-koordinator i KKSB-së Besart Tofaj, rreshteri i policisë në Junik Dinë Tofaj, dhe përfaqësuesit nga FSK-ja Amrush Morina dhe Gentrit Fazliu.

Mbledhjen e Parë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024 e shpalli të hapur koordinatori i KKSB-së z. Besart Tofaj, i cili përshëndeti pjesëmarrësit në këtë takim, dhe nga anëtarët e Këshillit kërkoj miratimin e Rendit të Ditës si më poshtë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut,
3. Kodi i Etikës, personeli mjekësor, dhe gjendja me barna dhe materiale esenciale në QKMF në Junik,
4. Gjendja në shkolla dhe diskutimi mbi ecurinë e procesit arsimor,
5. Mirëmbajtja e shkollave, siguria në dhe përreth objekteve shkollore, dhe
6. Të ndryshme.

Z. Xhavit Gaxherri propozoj që pikët katërt dhe pesë e këtij Rendi të Ditës të bashkohen në një pikë, pasi që të dy këto pika kanë të bëjnë me çështjen e arsimit.

Me këtë propozim u pajtuan të gjithë anëtarët e KKS-së të pranishëm në këtë mbledhje, dhe me këtë ndryshim ky Rendi i Ditës u miratua me dhjetë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

### **Pika e Parë të Rendit të Ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Koordinatori z. Besart Tofaj kërkoj shqyrtimin e procesverbalit të kaluar, i cili me 10 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e KKS-së.

### **Pika e Dytë e Rendit të Ditës, Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut**

Fjalën e mori komandanti i Policisë në Junik z. Rasim Sylja, i cila tha, gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut në përgjithësi është e qetë. Për këtë vit kalendarik kemi pasë vetëm një rast. Aksidente në trafik nuk kemi pasë. Në muajin Janar janë shqiptuar 66 tiketa. Një ndër prioritetet e planit të punës dhe objektivat për vitin 2024 është edhe trafiku, pra rregullimi i trafikut që ka qenë si pikë e dobët për Policinë e Kosovës.

Situata me parkingje dhe rregullim të trafikut është në përmirësim e sipër, ndërsa një ndër prioritetet për ne është edhe siguria në shkolla.

Në aspektin e rendit publik sa i takon Policisë së Kosovës jashtë rrethojave të shkollave ne do të vazhdojmë me projekte që i kemi pasë, dhe ato janë projekte në vazhdimësi. Do të mundohemi që ta rregullojmë dhe të bëjmë më të mirën sa i përket rendit publik dhe trafikut, që do ta qesim në nivelin e duhur. Duke pasë parasysh vitin që e lamë pas dhe muajin Janar të këtij viti nuk kemi pasë ndonjë rast të theksuar i cili mund ta prish imazhin e sigurisë ose të Policisë së Kosovës.

Z. Ruzhdi Shehu tha, reshjet e borës ishin të papritura dhe sipas Entit Meteorologjik lajmërimi është bërë me kohë, por edhe përgatitjet janë bërë me kohë dhe janë kontraktuar operatorët. Janë bërë edhe angazhime nga stafi i Komunës, ku janë shfrytëzuar disa pajisje të vogla që kanë qenë në dispozicion për pastrimin e trotuareve dhe disa rrugëve malore, ku të gjitha kanë qenë të kalueshme, por duhet pasë parasysh që kapacitetet e policisë janë të vogla sepse Juniku ka territor të zgjeruar, që ka diku rreth 77 km<sup>2</sup>. Pra, kjo situatë është mirëmenaxhuar dhe mirëmbajtur deri më tani. Kemi pas poashtu erëra të forta dhe dëmtime të disa çatave, dhe ne kemi bërë një raport të vlerësimit të cilin do ta dërgojmë prapë në Ministri, dhe të shohim nëse kanë mundësi që të na mbështesin për familjet e dëmtuara dhe fermerët.

Z. Xhavit Gaxherri tha, me rastin e reshjeve të borës ka patur defekte në furnizimin me rrymë elektrike

dhe me internet në Komunën e Junikut, ku janë dëmtar shtyllat elektrike dhe kabllot e internetit, por që janë sanuar defektet, por që telat dhe ballot kanë mbetur të shtrira përtokë. Do të ishte si **kërkesë** për Drejtorinë e Shërbimeve Publike të bëjë vlerësimin e shtyllave elektrike që bartin tension të lartë, me theks kah tranziti, ku disa shtylla paraqesin rrezik.

Z. Ruzhdi Shehu tha, unë kam qenë në kontakt me KEDS-in lidhur me këtë, por veprimet e tyre janë shumë të plogështa në Komunën e Junikut, ndërsa ata janë ankuar se nuk po u ndihmon Komuna. Ne kemi ndihmuar aty ku kemi pasë mundësi. Kemi ndihmuar në hapjen e gropave për shtyllat dhe kjo është bërë edhe përmes sektorit privat. Pra kjo nuk qëndron.

Unë kam bërë incizimin e terrenit dhe i kam cekë se ku janë shtyllat e dëmtuara dhe problemet me energji elektrike, dhe do t'ua dërgojmë prapë ankesat dhe kërkesat tona atyre. Pra, ky është problemi, stabiliteti me energji elektrike në Komunën e Junikut. Investimet e tyre në këtë fushë janë të pakta apo nuk ka fare investime.

Z. Qamil Jasiqi tha, unë kam vërejtje të KEDS-i në lidhje me tensionin e lartë, ku kjo ndërmarrje po shkakton dëme të panevojshme në pemishte dhe në prona private gjatë shtrirjes së rrjetit të tensionit të lartë.

Z. Ruzhdi Shehu tha, këto raste duhet të identifikohen dhe të lajmërohen edhe në polici.

### **Pika e Tretë e Rendit të Ditës,**

#### **Kodi i etikës, personeli mjekësor, dhe gjendja me barna dhe materiale esenciale në QKMF në Junik**

Kryetari z. Ruzhdi Shehu tha, sa i përket kodit të etikës dhe personelit mjekësorë ne kemi edhe një numër të telefonit ku mund të bëhet ankesë, si dhe kemi rutinë e ankesave ku qytetarët mund t'i parashtrojnë kërkesat e tyre në lidhje me sjelljen dhe kodin e etikës që është në kuadër të shërbimit shëndetësor në QKMF, ndërsa deri më tani nuk kemi pasë ndonjë ankesë.

Sa i përket furnizimit me barna esenciale, jemi të kënaqur me furnizimin nga lista esenciale e barnave dhe materialeve shpenzuese. Furnizimi është bërë nga ana e Ministrisë, dhe në këtë drejtim nuk kemi pasë probleme. Është me rëndësi ta dini që QKMF-ja tani funksionon 24 orë, 7 ditë në javë me shërbime shëndetësore, i cili shërbim nuk ka qenë që nga themelimi i Komunës. Përveç qytetarëve të Komunës së Junikut, shërbime marrin edhe qytetarët e fshatrave përreth, pra të zonës kufitare me Shqipërinë, konkretisht ata të Komunës së Gjakovës, dhe kemi rritje të shërbimeve që kryhen brenda muajit, të cilat nuk kanë qenë deri më tani në QKMF.

Furnizimi me barna esenciale do të bëhet prapë dhe do të kryhen të gjitha shërbimet e domosdoshme. Pra, gjendja është shumë e mirë. Kemi edhe automjetin që kemi marrë si donacion nga Ministria e Shëndetësisë, me të cilin bëjmë edhe vizitat e pacientëve nëpër shtëpi për moshat mbi 65 vjeç, si dhe për gratë shtatzëna, sipas kërkesave. Ne jemi të kënaqur me këtë gjendje, por kërkohet mirëmbajtje për këto shërbime.

### **Pika e Katërt e Rendit të Ditës**

#### **Gjendja në shkolla dhe diskutimi mbi ecurinë e procesit arsimor dhe mirëmbajtja e shkollave, siguria në dhe përreth objekteve shkollore**

Drejtori z. Xhavit Velijaj tha, gjendja në shkolla, në infrastrukturë, në mirëmbajtje në përgjithësi është e mirë, ndërsa sa i përket ecurisë së procesit mësimor është duke vijuar normalisht sipas planeve që i kanë shkollat.

Siç iu kam njoftuar në shkollën e re tani ka vetëm një ndërrim, gjendja është stabilizuar dhe procesi mësimor zhvillohet moralisht. Vitin e kaluar kemi investuar në rregullimin e oborrit dhe pjesa pas sallës së sportit është në proces sipas projektit, ndërsa është bërë lysterja e objektit brenda gjimnazit, në mënyrë që higjiena të jetë në nivel, ndërsa siguria është e mirë. Kemi dy objektet, si në Gjimnaz dhe në Shkollën Filllore, që janë rrethojat e hapësirave shkollore, ku në Shkollën Filllore janë zhvilluar disa punime, por kemi nevojë që të investojmë prapë të rrethojat.

Të kamerat e sigurisë në shkollën e re kemi investuar vitin e kaluar, që pothuajse është përmbyllur si projekt, por ka mbet vetëm edhe një pjesë kah salla e sporteve, dhe besoj që do të përfundon këtë vit. Policia vazhdimisht kanë ndihmuar dhe është kujdesur për mirëmbajtjen e sigurisë në trafik, sepse aty kemi edhe autobusin e transportit të nxënësve, me ç'rast policinë i falënderojmë shumë.

Z. Ruzhdi Shehu tha, siç u tha transporti i nxënësve është i siguar, mirëpo duhet edhe çerdhja e fëmijëve nga mosha 1-5 vjeç të funksionalizohet.

Rreshteri i Policisë z. Dinë Tofaj tha, bashkëpunimi ndërinstitucional në Komunën e Junikut është i mirë, ndërsa kemi një projekt që do ta realizojmë, dhe falënderoj drejtorin e Arsimit z. Xhavit Velijaj për miratimin e tij, ku janë disa tema që do të ligjërohet në Shkollën Filllore që fillojnë nga muaji Shkurt. Këto tema janë; bullizimi dhe masat parandaluese, pasojat e përdorimit të narkotikeve, dhuna në familje, masat e sigurisë ndaj keqpërdorimeve me internet, parandalimi i ngacmimeve seksuale, masat ligjore ndëshkimore, respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik, dhe ruajtja e ambientit dhe trashëgimisë kulture, të cilat do të diskutohen gjatë secilit muaj si tema të ndara veç e veç, të cilat do të ligjërohen në Shkollën Filllore. Ndërsa, do të kërkojmë bashkëpunim edhe me drejtorin e Gjimnazit, dhe të shohim se cilat tema janë të nevojshme të diskutohen në Gjimnaz, poashtu. Unë falënderoj edhe KLSP-në për projektin për shirita flourocetë, të cilët do të shpërndahen ndërkohë për nxënësit e ciklit të ultë, për shkak të sigurisë në komunikacion gjatë lëvizjes së tyre nga shkolla në shtëpi dhe anasjelltas, sidomos gjatë motit me të reshura apo me mjegulla.

Z. Arber Gjota tha, lidhur me mirëmbajtjen e shkollave ne si KLSP kemi planifikuar një takim me KFOR-in, ku kemi paraparë që në formë të një projekti të kërkojmë disa makineri për pastrim të shkollës, sepse shkolla ka nevojë për mirëmbajtje.

Dua të theksoj se ne si KLSP jemi përfitues të projektit për pajisje teknologjike. Kemi 23 pasqyra të komunikacionit që është bërë dorëzim-pranimi i tyre, të cilat do të vendosen shumë shpejtë nëpër udhëkryqet e Komunës së Junikut, si dhe janë siguar edhe 175 shirita me dritë flourocetë për nxënësit, për përdorim gjatë kushteve të dobëta atmosferike ose në orët e mbrëmjes gjatë procesit mësimor, që do të ndikojnë sadopak në sigurinë e trafikut tek nxënësit.

Z. Xhavit Gaxherri përshëndeti vendosjen e kamerave të sigurisë në shkolla dhe transportin e nxënësve, si dhe falënderoj KLSP-në për shiritat me dritë për nxënësit, si dhe pasqyrat e komunikacionit për udhëkryqet e Komunës. Poashtu, kërkoj që të përfundohen rrethojat e shkollëve emergjente në objektin e ri të shkollës.

Poashtu tha, është më rëndësi të cekët si informatë së Këshilli i Prindërve të nxënësve të shkollave në koordinim me drejtorinë e shkollës ka propozuar bartjen e uniformave të nxënësve në Shkollën Filllore,

ndërsa theksoj se është hapur tenderi për furnizim me këto uniforma, të cilat do të kushtojnë rreth 25.00 €. Kjo do të krijonte barazi për nxënësit brenda shkollës, dhe lidhur me këtë çështje kërkoj edhe angazhimin e prindërve të nxënësve.

Z. Xhavit Velijaj tha, ne për shkallët emergjente kemi biseduar me Ministrinë, por në kuadër të projekteve kjo nuk është paraparë. Ata do të kenë një projekt të veçantë për vendosjen e shkallëve emergjente, të ngjashme sikurse në shkollat tjera. Ne po presim që kjo të realizohet nga Ministria.

Z. Ruzhdi Shehu tha, fatkeqësisht këto projekte të shkollave kanë mangësi, por dalja emergjente është e domosdoshmëri dhe obligim ligjor, si dhe qasja për personat me aftësi të kufizuara, por nëse Ministria nuk e kryen këtë punë, ne duhet të angazhohemi vet, sepse këtu është në pyetje siguria e nxënësve.

### **Pika e Pestë e Rendit të Ditës Të ndryshme**

Z. Ruzhdi Shehu tha, desha t'u informoj se ne kemi një aktivitet me rastin e 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë, ku do të mbahet një garë në atletike për grupmoshat dhe disiplinat e ndryshme në Komunën e Junikut, ku do të ketë pjesëmarrje nga e gjithë Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Ne duhet të bëjmë një plan dhe të sigurohen parkingje për automjete, si dhe lëvizje të lirë për qytetarët. Pra, kjo do të mbahet me datën 16 Shkurt, 2024. Për këtë do të angazhohet një grup punues, në mënyrë që kjo garë të organizohet dhe të kaloj sa më mirë.

Tjetër informatë është se ne si Komunë kemi miratuar strategjinë kundër dhunës në familje, e cila është e shpeshtë, dhe e cila strategji në kuadër të saj përfshinë mekanizma relevante të komunës sonë. Kjo do të publikohet shumë shpejtë edhe në web-faqen e Komunës.

Z. Arber Gjota pyeti nëse ka konkurs të shpallur për pozitën për zyrtaren për barazi gjinore, sepse siç dihet zyrtarja ka kaluar në një pozitë tjetër.

Z. Ruzhdi Shehu tha, është emëruar që këtë pozitë ta plotësoj si detyrë shtesë zyrtarja e re znj. Ariola Krasniqi.

Z. Rasim Sylja tha, rruga për Gjeravicë është shtruar në asfalt, dhe ne do të bisedojmë edhe me KLSP-në dhe me Shoqatën e Bjeshkatarëve, që të mbajmë një takim që të gjejmë ndonjë donacion për sigurimin e disa pllakave vetëdijesuese-promovuese rreth sigurisë në trafik.

Policia do të jetë e pranishme në këtë rrugë, sepse kemi fluks më të madh për në bjeshkë, dhe në këtë mënyrë do të ndikohej rreth sigurisë në komunikacion për rrugën e bjeshkës.

Poashtu desha të falënderoj Komunën, e cila mbanë takime me banorët e fshatrave dhe lagjeve lidhur me pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve sidomos për fshatrat Jasiq dhe Gjocaj, veçanërisht gjatë stinës së dimrit.

Me kaq, koordinatori, z. Besart Tofaj shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KKSB-së.

Procesmbajtësi,

Kryetari i Komunës, Kryesues i KKSB-së

---

Gëzim Geci

---

Ruzhdi Shehu